

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 23 SHTATOR 2021

Kryetare,

Çështja është shumë e thjeshtë, e shtruar edhe në Konferencën e Kryetarëve. Bëhet fjalë për mënyrën sesi do të zhvillohen punimet në komisionet parlamentare. Ju e dini fare mirë, edhe publiku e di fare mirë se si janë zhvilluar punimet e komisioneve në legjislaturën e kaluar, online. Njëri në kafe, tjetri në plazh, tjetri në makinë, tjetri me gotën e rakisë para dhe askush nuk e merrte vesh nga publiku, ata jo e jo, se çfarë ishin duke diskutuar, duke votuar dhe cilat interesa të publikut ishin duke mbrojtur. Ajo çfarë po themi ne është fare e thjeshtë. Po, ka pasur një situatë të gjendjes së jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore. Baza e vetme normative është kjo për të ndryshuar formatin e mënyrës së punës së komisioneve, por nuk është më. Lidhur me pandeminë, qeveria këtë gjë ka thënë, e kemi kaluar me sukses, nuk ndodh gjë. Në fakt, baret sot i ke plot, fëmijët shkojnë nëpër shkolla, parlamenti këtu, ja ku jemi të gjithë, pse u dashka që vetëm komisionet parlamentare, atje ku edhe diskutohet në mënyrë më të detajuar dhe ku zhvillohet në mënyrë masive debati parlamentar, të bëhen online? Për t'ia fshehur publikut? Pse u dashka të japim një sinjal, ndërkohë që fëmijët shkojnë në shkolla, njerëzit shkojnë në punë, madje ju para disa ditësh keni shkuar në koncerte?! Pra, për ata nuk paska problem, por vetëm ne deputetët duhet të mbrohemi duke mos shkuar në komisionet parlamentare për shkak të pandemisë? Ky është sinjali më i gabuar që u japim ne njerëzve, për vete mbrohemi, kurse për ata askush nuk ka mëshirë.

Për këtë arsye, zonjë, ne do të duhet që atë vendim të marrë nga parlamenti i mëparshëm ta konsiderojmë të shfuqizuar dhe të kthehemi në normalitetin e veprimtarisë së komisioneve. Do të më falni edhe pak sa t'ju sqaroj diçka të fundit! Ne nuk duam kurrsesi që jeta e askujt, aq më tepër e deputetëve, të vihet në rrezik. Po a nuk jemi ne në valën e një vaksinimi, apo jo? Të vendoset rregulli: deputetët të vaksinohen dhe të paraqesin gjithmonë në mbledhjet e komisioneve rezultatet e testit. Ja kështu realizojmë edhe mbrojtjen e jetës së deputetëve, por mbi të gjitha i garantojmë publikut të drejtën për t'u informuar për veprimtarinë e parlamentit dhe për të dëgjuar diskutimet e parlamentarëve. Në fund fare, për ta mbyllur, mjafton të shihni vetëm dokumentet parlamentare të legjislaturës së kaluar. Në gjysmën e tyre thuhet: nuk dëgjohet, nuk kuptohet, nuk dihet se si votohet, nuk dihet se si është kuorumi. Kjo është të asgjësosh pikërisht atë që është thelbi i demokracisë, parlamentarizmin.